



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING	
Njësia Org. Org. jedinica Org. Unit	SA-02
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	8642-2/25
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages	-06-
Data Datum Date	05.06.2025
PRISHTINE/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	19.05.2026
REFERENC-Ë:	25/8642/759/DMM
PËR/ZA/TO:	Spitali Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" Prizren
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr. prot.: 25/8642/759/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për Spitalin e Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa", Prizren, me nr. prot. 25/8642/759/DMM, të datës 01.12.2025 për trajtimin e mbetjeve spitalore ne Spitalin e Përgjithshëm te Prizrenit, Prizren.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08//L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958-4/23 datë 21.04.2026), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Spitali i Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa", Prizren, me nr. prot.: 25/8642/759/DMM, **pajiset me Pëlqim Mjedisor** për trajtimi i mbetjeve spitalore ne Spitalin e Përgjithshëm te Prizrenit, Prizren, ngastrat kadastrale nr P-71813068-08442-0-315-0, nën kushtet si vijon:


- Të bëhet izolimi dhe shtrimi me material të papërshkueshëm nga uji i sipërfaqeve ku do të pranohen, ruhen dhe trajtohen mbetjet, duke përfshirë mbeturinat plastike, letrën, metalet, qelqin, mbeturinat urbane, gomrat, vajrat, mbetjet medicinale dhe barnat e skaduara.
- Të vendoset dhe të funksionalizohet sistemi për grumbullimin, trajtimin dhe shkarkimin e kontrolluar të ujërave industriale, ujërave të zeza dhe ujërave

Faqe 2 nga 6

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



atmosferike nga sipërfaqet operationale, përfshirë separatorin dhe gropën septike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Të ndalohet shkarkimi i ujërave të ndotura në mjedis pa trajtim paraprak dhe të merren të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore, nëntokësore dhe tokës nga ndotja.
- Të bëhet mbyllja hermetike e gypave dhe kanaleve për transportimin e pluhurit dhe gazrave, si dhe izolimi i të gjitha pikave potenciale gjeneruese të pluhurit dhe emetimeve të tjera në ajër.
- Të sigurohet funksionimi i vazhdueshëm i pajisjeve për kontrollin dhe reduktimin e emetimeve në ajër, në përputhje me vlerat kufitare të përcaktuara me legjislacionin përkatës.
- Pranimi, ruajtja, transporti dhe trajtimi i mbetjeve spitalore dhe mbetjeve të tjera të rrezikshme të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbetjeve.
- Të vendosen pajisje dhe kontejnerë adekuatë për grumbullimin, ndarjen dhe deponimin e mbetjeve të ngurta dhe të lëngëta sipas kategorive përkatëse.
- Mbetjet e trajtuara dhe mbetjet sekondare të gjeneruara nga procesi t'u dorëzohen vetëm operatorëve të licencuar për menaxhimin dhe trajtimin e tyre.
- Të kryhet monitorimi periodik i emetimeve në ajër, i cilësisë së ujërave të shkarkuara dhe i parametrave të tjerë relevantë mjedisorë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Rezultatet e monitorimit dhe analizave laboratorike t'i raportohen rregullisht institucioneve kompetente, përfshirë Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK).



- Të hartohet dhe zbatohet plani për parandalimin, reagimin dhe rehabilitimin e mjedisit në rast të ndotjes, aksidenteve apo dëmtimeve mjedisore gjatë ndërtimit, operimit dhe pas përfundimit të veprimtarisë.
- Të sigurohen masa për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe të realizohen trajnime periodike të punëtorëve në fushën e mbrojtjes së mjedisit, menaxhimit të mbetjeve dhe reagimit në raste emergjente.
- Bazuar në Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat, ndalohet zhvillimi i veprimtarisë dhe ndërtimi i objekteve që nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmbytjet në një distancë më të vogël se tridhjetë (30) metra nga vija e ujërave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.
- Operatori është i obliguar të njoftojë autoritetin kompetent për çdo ndryshim të kapacitetit, teknologjisë, llojit të mbetjeve ose veprimtarisë së projektit para zbatimit të ndryshimeve.
- Para fillimit të operimit, operatori duhet të sigurojë të gjitha lejet, licencat dhe autorizimet e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi.
- Të bëhet nivelizimi, rregullimi, gjelbërimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të lira brenda parcelës dhe përgjatë rrethojës së kompleksit.

Aplikuesi përpos kushteve të lartshënuara duhet të u përmbahet edhe kushteve të paraqitura raportin e VNM-së.

Nëse nuk respektohen kushtet e lartcekura, pëlqimi do të merret (anulohet).

Vërejtje: Vonesa në dhënien e përgjigjes është shkaktuar si rezultat i volumit të madh të kërkesave në procedurë dhe ndryshimit të përbërjes së Komisionit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM). Informohet se shqyrtimi i lëndës deri në fazën e mbajtjes së debatit publik është kryer nga Komisioni paraprak.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lartcekura, pëlqimi do të anulohet (revokohet).

A r s y e t i m

Faqe 4 nga 6

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmphi>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumantacionin përcjellës të dorëzuar nga Kompania Spitali Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa", Prizren, me nr. prot.: 25/8642/759/DMM, për Pëlqim Mjedisor për Pëlqim Mjedisor për trajtimi i mbetjeve spitalore ne Spitalin e Prizrenit, Prizren, ngastrat kadastrale nr. P-71813068-08442-0-315-0, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nxjerrë Vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.

Ky Pëlqimit Mjedisor lëshohet konform nenit 29 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 te Ligjit për VNM 08/L-181.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 25/8642/759/- ZSP/ /26 datë: 19.05.2026

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. AMMK-së
5. Kabinetit të Ministrit
6. Komunës së Prizrenit
7. Divizionit për komunikim me publikun
8. Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore
9. Arkivit të MMPHI

Bajram Kafexholli

UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH

2. SHTOJÇË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithsesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.



5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.

